



GJYKATA
E RRETHIT
GJYQËSOR
FIER



GJYKATA
E RRETHIT
GJYQËSOR
FIER

Për çdo informacion tjetër lidhur me këtë projekt,
mos hezitoni të kontaktoni me Kancelarinë e Gjykatës,
në adresën:

Lagjja 28 Nëntori, Rruga Dervish Hekali, Fier

Tel/Fax: 034231590

Web-site: gjkata.gov.al/rrethi-fier/gjkata-e-rrethit-fier/

E-mail: klodiana.malaj@hotmail.com

Tetor 2017. Ky botim u realizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri me mbështetjen e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Programi i USAID-it Drejtësi për të Gjithë. Brendia tij nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, USAID-it apo të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PROJEKTI “PËR NJË DREJTËSI PA VONESA”

**Qytetarë, avokatë, prokurorë, përfaqësues institucionesh
qendrore e lokale, ekspertë të fushave të ndryshme,
bëhuni pjesë e nismës “Për një drejtësi pa vonesa”!**

Të gjithë së bashku, t'u themi ndal vonesave të panevojshme në proceset gjyqësore!

Në fushën e së drejtës, drejtësia e vonuar është një drejtësi e mohuar. Për fat të keq, vonesat dhe tejzgjatjet e proceseve gjyqësore ndodhin jo rrallë në gjykatat shqiptare. Me vendosmërinë për ta ndryshuar këtë situatë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier po ndërmerri një sërë hapash konkrete për të shmangur vonesat e panevojshme në gjykim.

Duke filluar nga muaji tetor 2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier kërkon të informojë, këdo që i drejtohet asaj, si më poshtë vijon:

Momenti i dorëzimit të kërkesëpadisë: Do të kërkohej nga pala paditëse që të plotësohet formulari me të dhënat e kontaktit të paditësit, të të paditurit, adresat e plota, numrin e telefonit, të dhëna lidhur me çdo person tjetër apo numër tjetër kontakti, që mundëson njoftimin e palës si dhe të plotësojë formularin model për "dhënien e pëlqimit për njoftimin edhe nëpërmjet postës elektronike" (kur ekziston kjo mundësi). Kërkesë-padia nuk do të pranohet pa këtë formular. Po ashtu, kërkesë-padia duhet të përmbajë nga pikëpamja formale të gjithë elementët e saj sipas Kodit të Procedurës Civile.

Kancelari do të sigurohet që pala paditëse të paraqesë provat në formën e kërkuar nga ligji dhe në numër kopjesh sa janë palët; të përcaktojë që në momentin e depozitimit të padisë, vlerën e padisë, dhe në bazë të saj sipas rastit të kryejë pagesën e taksës së regjistrimit të padisë (për ata që përjashtohen nga taksat, të bashkëngjitet kërkesa për përjashtim dhe aktet provuese që mbështesin këtë kërkesë). Regjistrimi i padisë do të kryhet vetëm, pasi paraqitet kopja e mjetit të identifikimit të paditësit/ paditësve, në mënyrë që të shmangët dhënia e gjeneraliteteve jo të sakta.

Avokatia: Avokatët të sigurohen që në momentin e depozitimit, kërkesë-padia të plotësojë të gjithë elementët e kërkuar nga K.Pr.Civile, përfshirë edhe provat e siguruar nga institucionet përkatëse. Formulari i të dhënave të kontaktit të plotësohet edhe nga avokatët. Gjykata vendos në dispozicion kopjen me udhëzimet përkatëse për plotësim. Kërkesat për gjykim të shkurtuar të dorëzohen paraprakisht dhe gjykata të vihet në dijeni në një kohë më të hershme.

Gjykata do të anulohet seancën kur vihet në dijeni që më parë se seanca e planifikuar nuk do të mund të zhvillohet dhe palët do të njoftohen paraprakisht për një datë të dytë. Relatimi i shkakut të shtyrjes do të kryhet gjatë zhvillimit të seancës pasardhëse.

Prokuroria: Prokurorët në bashkëpunim me oficerët e policisë gjyqësore të sigurojnë që në momentin e hetimit adresa të sakta të dëshmitarëve si dhe të të pandehurve. Deklarimet të sillen paraprakisht para zhvillimit të seancës.

Në çështjet penale, palëve u kërkohej të paraqesin në të njëjtën seancë pretendimet përfundimtare, aty ku është e mundur, sidomos në gjykimet e posaçme. Edhe kur procedohet me gjykim të shkurtuar, prokurorit sikurse avokatit, do t'u kërkohej të paraqesin pretendimet përfundimtare brenda të njëjtës seancë, pa kërkuar shtyrjen e gjykimit për këtë shkak, pasi në rastin konkret, kërkesa për gjykim, e paraqitur nga prokurori dhe e pranuar nga gjykata si e tillë, do ishte e njëjtë edhe me diskutimet përfundimtare të çështjes në gjykim.

Prokurorët dhe avokatët duhet të jenë gjithmonë të pranishëm në seancë. Nuk do të pranohet asnjë kërkesë shtyrje e pashoqëruar me prova shkresore ashtu siç e kërkon edhe ligji.

Ekspertët: Dorëzimi i aktit të ekspertimit disa ditë para zhvillimit të seancës me qëllim që palët të vihen në dijeni paraprakisht. Pala e ngarkuar me pagesën dorëzon tek sekretaria e gjykatës vërtetim të parapagimit të ekspertit.

IEVP: Kërkesat penale që i drejtohen gjykatës nga të dënuarit të hartohen me ndihmën e një juristi të institucionit. Kërkesat nga të dënuarit t'i vendosen paraprakisht në dispozicion gjykatës.

Komisariati i Policisë: Komunikimi i vendimeve përsa i takon urdhrave të mbrojtjes do të bëhet përmes postës elektronike, pasuar nga një konfirmim për marrjen e këtyre vendimeve nga Komisarati.

Institucionet vendore: Do të mbahet komunikim i ngushtë me ZVRPP, Bashkinë (Zyra e Shërbimeve Sociale), ALUIZNI-n, Drejtorinë Rajonale të Gjendjes Civile duke kërkuar pjesëmarrjen në seancë të stafit të tyre, si dhe dorëzimin e akteve/dokumenteve të lidhura me gjykimin.

Zyra Postare: Gjykata do të përdorë mënyra alternative të njoftimit përmes postës elektronike dhe telefonit, të deklaruara prej qytetarit në formularin ku jepet pëlqimi i palës për t'u njoftuar. Gjykata do të shpërndajë bashkëngjitur me fletë-thirrjen dhe provat e palës paditëse edhe "formularin e kontaktit për palën e paditur" ose "palën e tretë", e cila duhet të kthehet e plotësuar në gjykatë nga nëpunësi postar, bashkë me fletë-thirrjen e nënshkruar. Punonjësit/postierët e postës në bashkëpunim me titullarin e institucionit, do të udhëzohen dhe trajnohen herë pas here me rregullat procedurale të njoftimit, me qëllim që të realizohet njoftimi i palëve sipas kërkesave të K.Pr.Civile dhe K.Pr.Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier u bën thirrje qytetarëve, institucioneve qëndrore e lokale dhe ekspertëve e profesionistëve ligjorë që të bëhen pjesë e kësaj nisme, duke mos lejuar zvarritjen e proceseve gjyqësore dhe duke kontribuar në përfundimin e tyre brenda një afati të arsyeshëm!

Pjesëmarrja dhe angazhimi aktiv i të gjithëve është thelbësor për dhënien e drejtësisë në kohë

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier mbështetet në këtë projekt nga këta partnerë dhe institucione:



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION